

Politika e privatësisë gjatë zhvillimit dhe testimit të produktit (mjedisi rrethues i automjetit)

A. Qëllimi i politikës së privatësisë

Me anë të kësaj politike të privatësisë, ju informojmë rreth përpunimit të të dhënave tuaja personale nga kompania AUDI AG, Auto-Union-Straße 1, 85057 Ingolstadt, Gjermani ("ne", "na", "e jona" ose "Audi") në lidhje me përdorimin e një automjeti për prova testuese ("provat e drejtimit të automjetit") në rrugë publike. Kompania Audi përdor të ashtuquajturat automjete prove për zhvillimin dhe testimin e produktit dhe sigurinë e tij. Këto automjete janë të pajisura me sensorë, aparatura matëse, si dhe me teknologji për regjistrimin video të matjeve optike të dimensioneve, dhe janë të etiketuara siç duhet në karrocieri.

Provat e drejtimit të automjetit në rrugë përfshijnë përdorimin e automjetit gjatë procesit të zhvillimit të tij, si dhe gjatë testimit të sigurisë, vlerësimit gjatë ecjes, vlerësimit të statusit dhe provave të miratimit. Këto prova të drejtimit të automjetit do të kryhen, ndër të tjera, në zona publike.

Informacione të përgjithshme mbi përpunimin e të dhënave personale nga kompania Audi, mund të gjenden në faqen tonë në internet <https://www.audi.de/de/brand/de.html#layer=/de/brand/de/tools/navigation/layer/rechtliches.html&data-innerlayer=true>

E dhënë personale është çdo informacion në lidhje me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm ("subjekti i të dhënave"). Person fizik i identifikueshëm është kushdo që mund të identifikohet drejtpërdrejt apo tërthorazi, duke iu referuar në veçanti me anë të një elementi identifikues, si emri, numri identifikimit, të dhënat e vendndodhjes, një elementi identifikues në linjë, ose një a më shumë karakteristikave të veçanta mbi identitetin fizik, fiziologjik, gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor apo social të tij.

Përpunim është çdo veprim ose grup veprimesh që janë kryer mbi një të dhënë ose një grup të dhënash personale, qoftë me mjete automatike ose jo, si mbledhja, regjistrimi, organizimi, strukturimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, rikthimi, konsultimi, përdorimi, përhapja me transmetim, shpërndarje ose ndryshe duke i vënë në dispozicion, radhitja ose kombinimi, bllokimi, fshirja ose shkatërrimi.

B. Informacione të përgjithshme

I. Kush është kontrolluesi i përpunimit?

Në kuptimin e nenit 4(7) të Rregullores së Përgjithshme për të Dhënat Personale (RRPMDH), siç përshkruhet në pikën C më poshtë, kompania AUDI AG, Auto-Union-Straße 1, 85057 Ingolstadt, Gjermani është **Kontrolluesi**.

II. Kë mund të kontaktoj?

Nëse keni pretendime për të drejtat tuaja për mbrojtjen e të dhënave, lutemi të na kontaktoni në një nga mënyrat e mëposhtme:

<https://gdpr.audi.com/>

Në këtë faqe, do të gjeni informacion të mëtejshëm mbi mënyrën si mund të ngrini pretendime mbi të drejtat tuaja për mbrojtjen e të dhënave. Gjithashtu, mund të na kontaktoni përmes postës, duka na shkruar në adresën e mëposhtme:

AUDI AG, DSGVO-Betroffenenrechte, Auto-Union-Straße 1, 85057 Ingolstadt, Gjermani

III. Të dhënat e kontaktit të oficerit tonë për mbrojtjen e të dhënave

Nëse jeni të shqetësuar për mbrojtjen e të dhënave, mund të kontaktoni **oficerin e shoqërisë tonë për**

mbrojtjen e të dhënave në adresën:

AUDI AG, Datenschutzbeauftragter, Auto-Union-Straße 1, 85057 Ingolstadt, Gjermani

Postelektronike: datenschutz@audi.de

IV. Cilat janë të drejtat e mia?

Në varësi të juridiksionit tuaj, si subjekt i të dhënave, gëzoni të drejtat e mëposhtme për mbrojtjen e të dhënave:

1. E drejta e qasjes në të dhëna

Keni të drejtë të merrni informacion mbi të dhënat që kompania Audi ka ruajtur në lidhje me ju dhe qëllimin e përpunimit të të dhënave, transferimin e të dhënave që kompania Audi ka kryer, si dhe të merrni një kopje të të dhënave personale të ruajtura në lidhje me ju.

2. E drejta e korigjimit

Keni të drejtë të kërkonte kryerjen pa vonesë të pajustificuar të korigjimit të të dhënave tuaja personale që nuk janë të sakta, si dhe plotësimin e të dhënave personale jo të plota që kompania Audi ruan në lidhje me ju.

3. E drejta e fshirjes

Keni të drejtë të kërkonte fshirjen pa vonesë të pajustificuar të të dhënave tuaja personale që kompania Audi ka ruajtur, nëse kërkesat ligjore janë përmbushur.

Kjo mund të ndodhë, në veçanti, nëse

- Të dhënat tuaja personale nuk janë më të nevojshme për qëllimin për të cilin janë mbledhur;
- Baza e vetme ligjore e përpunimit ka qenë pëlqimi juaj dhe e keni tërhequr atë;
- Ju keni kundërshtuar përpunimin bazuar në balancimin e interesave për shkaqe që lidhen me situatën tuaj të veçantë dhe nuk mund të provojmë se ka baza legjitime mbizotëruese për përpunimin;
- Të dhënat tuaja personale janë përpunuar në mënyrë të paligjshme; ose
- Të dhënat tuaja personale janë fshirë për përmbushjen e një detyrimi ligjor.

Nëse i kemi ndarë të dhënat tuaja me palë të treta, do t'i njoftojmë ato për fshirjen, për aq sa kërkohet me ligj.

Theksojmë se e drejta juaj për fshirjen e të dhënave i nënshtrohet disa kufizimeve. Për shembull, nuk na lejohet ose kërkohet të fshijmë të dhëna për të cilat kemi ende detyrimin t'i ruajmë për shkak të periudhës ligjore për ruajtjen e të dhënave. Po ashtu, të dhënat, të cilat janë të nevojshme për konstatimin, ushtrimin ose mbrojtjen e pretendimeve ligjore, përjashtohen nga e drejta juaj për fshirje.

4. Kufizimi i përpunimit

Ju keni të drejtë të kërkonte, në kushte të caktuara, kufizimin e përpunimit (d.m.th. shënimin e të dhënave personale të ruajtura në mënyrë që të kufizohet përpunimi i tyre në të ardhmen). Kërkesat janë:

- Kundërshtohet saktësia e të dhënave tuaja personale dhe kompania Audi duhet të verifikojë saktësinë e të dhënave tuaja personale;
- Përpunimi është i paligjshëm, por ju kundërshtoni fshirjen e të dhënave personale dhe, në vend të kësaj, kërkonte kufizimin e përdorimit të të dhënave personale;
- Kompania Audi nuk ka më nevojë për të dhënat tuaja personale për qëllime të përpunimit, por ju kërkonte të dhëna për krijimin, ushtrimin ose mbrojtjen e pretendimeve ligjore.

- Ju keni kundërshtuar përpunimin dhe verifikimi është në pritje të konstatimit nëse bazat ligjore të kompanisë Audi mbizotërojnë mbi tuajat.

Në rast të një kufizimi të përpunimit, këto të dhëna do të shënohen siç duhet dhe, me përjashtim të ruajtjes së tyre, do të përpunohen me pëlqimin tuaj për konstatimin, ushtrimin ose mbrojtjen e pretendimeve ligjore, për mbrojtjen e të drejtave të personave të tjerë fizikë ose juridikë, ose për një interes të rëndësishëm publik të Bashkimit ose të një Shteti Anëtar.

5. Transferueshmëria e të dhënave

Për aq sa përpunojmë automatikisht të dhënat tuaja personale që na janë dhënë mbi bazën e pëlqimit tuaj ose të një kontrate me ju (përfshirë kontratën tuaj të punës), keni të drejtë të merrni të dhënat në një format të strukturuar, që përdoret zakonisht dhe të lexueshëm nga pajisjet dhe t'i transferoni këto të dhëna tek një kontrollues tjetër pa asnjë pengesë nga kompania Audi. Gjithashtu, keni të drejtë që të dhënat personale të transferohen drejtpërdrejt nga kompania Audi tek një kontrollues tjetër, nëse është teknikisht e mundur dhe me kusht që kjo të mos cenojë të drejtat dhe liritë e të tjerëve.

6. E drejta për të kundërshtuar

Nëse i kemi përpunuar të dhënat tuaja personale mbi bazën e interesave legjitime ose në interesit publik, ju keni të drejtë të kundërshtoni përpunimin e dhënave tuaja personale për shkaqe që lidhen me situatën tuaj të veçantë. Gjithashtu, keni një të drejtë të pakufizuar për të kundërshtuar nëse i përpunojmë të dhënat tuaja për qëllimet tona të marketingut të drejtpërdrejtë. Për më tepër, lexoni "Informacionin mbi të drejtën tuaj për të kundërshtuar".

Në disa raste, ju japim gjithashtu një të drejtë shtesë të pakufizuar në kohë, përtej kushteve të privatësisë, për të kundërshtuar mbi bazën e balancimit të interesave. Për këtë, do t'ju informojmë në lidhje me karakteristikat ose shërbimet përkatëse.

7. Tërheqja e pëlqimit

Nëse keni dhënë pëlqim për përpunimin e të dhënave tuaja personale, mund ta tërhiqni atë në çdo kohë. Theksojmë se tërheqja do të ketë efekt vetëm për të ardhmen. Përpunimi që ka ndodhur përpara tërheqjes nuk do të preket.

8. Ankesat

Për më tepër, keni të drejtë të paraqisni ankesë pranë një autoriteti mbikëqyrës për mbrojtjen e të dhënave, nëse besoni se përpunimi i të dhënave tuaja personale është i paligjshëm. E drejta e paraqitjes së një ankese nuk cenon asnjë mjet tjetër administrativ ose gjyqësor. Adresa e autoritetit mbikëqyrës për mbrojtjen e të dhënave përgjegjës për kompaninë Audi është:

[...]

9. Informacion mbi të drejtën për të kundërshtuar

a. E drejta për të kundërshtuar për shkaqe që lidhen me situatën tuaj të veçantë

Keni të drejtë të kundërshtoni përpunimin e dhënave tuaja personale për shkaqe që lidhen me situatën tuaj të veçantë. Për këtë, duhet që përpunimi i të dhënave të kryhet për interesin publik ose në bazë të balancimit të interesave. Kjo gjen zbatim edhe për çdo profilizim. Për aq sa përpunimi i të dhënave tuaja personale është bazuar në balancimin e interesave, përgjithësisht prezumojmë se baza legjitime detyruese mund të dëshmohet, por, sigurisht, do ta shqyrtojmë çdo rast individualisht. Në rast kundërshtimi, të dhënat tuaja personale nuk do t'i përpunojmë më gjatë.

Përveç kur,

- mund të dëshmojmë se kemi baza legjitime detyruese për përpunimin e këtyre të dhënave, të cilat mbizotërojnë mbi interesat, të drejtat dhe liritë tuaja, ose
- të dhënat tuaja personale janë përdorur për konstatimin, ushtrimin ose mbrojtjen e pretendimeve ligjore.

b. Kundërshtimi i përpunimit të të dhënave tuaja për qëllimet tona të marketingut të drejtpërdrejtë

Kur të dhënat tuaja personale i përpunojmë për qëllime të marketingut të drejtpërdrejtë, ju keni të drejtë të kundërshtoni, në çdo kohë, përpunimin e të dhënave personale që lidhen me ju për këtë marketing. Kjo gjen zbatim edhe për profilizimin, në masën që ka lidhje me këtë marketing të drejtpërdrejtë. Nëse kundërshtoni përpunimin për qëllimin e marketingut të drejtpërdrejtë, të dhënat tuaja personale nuk do t'i përpunojmë më gjatë për këtë qëllim.

c. Kundërshtimi i përpunimit të të dhënave tuaja për përmirësimin e produktit dhe analizën e përgjithshme të klientit

Si pjesë e balancimit të interesave, ju japim një të drejtë tjetër për të kundërshtuar në lidhje me përpunimin e të dhënave tuaja për përmirësimin e produktit dhe analizën e përgjithshme të klientit.

Nëse kundërshtoni përpunimin për qëllimin e përmirësimit të produktit dhe/ose analizën e përgjithshme të klientit, të dhënat tuaja personale nuk do t'i përpunojmë më gjatë për këto qëllime. Vlerësimi i të dhënave të pandara ose ndryshe anonime vetëm për qëllime të pastra statistikore, nuk do të preket nga kjo.

d. Ushtrimi i të drejtës për të kundërshtuar

Kundërshtimi mund të ushtrohet në çdo formë dhe duhet, mundësisht, të dërgohet në adresat e personave të kontaktit të renditura në pikën B.II.

Kujdes, vini re se imazhet reale të trafikut të rrugëve publike, që do të regjistrohen nga automjeti i provës, do të përdoren vetëm për të kapur mjedisin rrethues të automjetit me qëllim zbulimin e pengesave dhe përdoruesve të tjerë të rrugës dhe për të shmangur me efikasitet aksidentet. Kjo është e nevojshme për të bërë të mundur drejtimin (gjysmë) autonom të automjetit. Regjistrimet video të bëra nga automjeti i provës do të përdoren për të zhvilluar funksione të automjetit të gatshme për tregun. Kompania Audi nuk mund dhe nuk ka për qëllim të identifikojë asnjë nga personat ose automjetet e regjistruara në video. Nëse është e zbatueshme, kompania Audi nuk është e detyruar të veprojë në përputhje me të drejtat e sipërpërmendura të informimit, korigjimit, fshirjes, kufizimit të përpunimit, transferueshmërisë së të dhënave dhe kundërshtimit. Nëse identifikimi nuk është i mundur, do t'ju japim prova. Në këtë rast, mund t'i jepni kompanisë Audi informacion shtesë që do të na mundësojë t'ju identifikojmë (p.sh. hollësi të pamjes dhe veshjes tuaj në momentin e regjistrimit video, vendin, kohën dhe datën e kontaktit me automjetin e provës, numrin e targës ose të paktën tipin dhe ngjyrën e automjetit të provës). Nëse ju identifikojmë me sukses me ndihmën e këtij informacioni shtesë, sigurisht që do të përmbushim të drejtat tuaja brenda sferës së detyrimeve tona që rrjedhin nga RRPMDH-ja.

V. Cilat të dhëna përpunojmë, për cilat qëllime dhe cila është baza ligjore e zbatueshme?

Për qëllimin e zhvillimit të produktit, shumë sensorë dhe pajisje matëse mund të instalohen në automjetin e provës, të cilat mbledhin të dhëna për kushtet e automjetit të provës dhe sjelljen e tij gjatë drejtimit. Këto të dhëna mund të përmbajnë të dhënat tuaja personale. Këto të dhëna personale mund të përfshijnë:

- Imazhe të mjedisit rrethues të automjetit (deri në 360°) dhe
- numrin e targës.

("të dhënat")

Të dhënat tuaja personale i përpunojmë mbi bazën e interesave tona legjitime ekskluzivisht për qëllimet e zhvillimit, testimit dhe provës, si dhe për masat e sigurimit të cilësisë (testet e nevojshme për sigurinë). Çdo përdorim tjetër nuk është i lejuar.

Është interes legjitim i kompanisë Audi të zhvillojë dhe ruajë funksionet e drejtimit të automjetit që lidhen me sigurinë, siç janë sistemet e ndihmës së drejtuesit dhe drejtimi pothuajse dhe plotësisht automatik i automjetit. Gjithashtu, synohet të përmirësohet siguria e produktit, automjetit dhe trafikut dhe të ulet numri i aksidenteve në trafik.

VI. Kush i merr të dhënat e mia?

Brenda kompanisë Audi, të dhënat tuaja i marrin ato subjekte që kanë nevojë të përmbushin detyrimet tona kontraktuese dhe ligjore, si dhe për të mbrojtur interesat tona legjitime (p.sh. procesi i zhvillimit të produktit i departamentit të zhvillimit teknik). Ofruesit e shërbimeve (të ashtuquajtur përpunues) që ne përdorim dhe pajtojmë, gjithashtu, mund të marrin të dhënat tuaja për këto qëllime. Përgjithësisht, të dhënat tuaja personale do t'i ndajmë me palë të treta vetëm nëse do të jetë e nevojshme për përmbushjen e kontratës, nëse ne ose pala e tretë ka një interes legjitim për përhapjen, ose nëse ju keni dhënë pëlqimin tuaj. Gjithashtu, të dhënat mund të ndahen me palë të treta (përfshirë organet e hetimit ose të sigurisë) në masën që do të na kërkohet me ligj, me urdhër ekzekutimi administrativ ose gjyqësor. Hollësitë rreth kategorive të përpunuesve që ne përdorim dhe të marrësve të tjerë që marrin të dhëna personale paraqiten më poshtë. Për shkak të përmasave dhe kompleksitetit të përpunimit të të dhënave nga kompania Audi, është e pamundur që, në këtë politikë të privatësisë, të rendisim individualisht çdo marrës të të dhënave tuaja personale. Për këtë arsye, do të specifikohen vetëm kategoritë e përgjithshme të marrësve.

1. Përpunuesit

Ofruesit e shërbimeve që përdoren dhe veprojnë në emër të kompanisë Audi (të ashtuquajtur përpunues) mund të marrin të dhëna për qëllimet e mëposhtme. Për marrjen e shërbimeve të caktuara, ne përdorim përpunues të kategorive të mëposhtme që na mbështesin në ekzekutimin e proceseve të biznesit tonë. Këtu përfshihen, në veçanti sipërmarrës të kategorive të mëposhtme:

- Shoqëritë brenda Grupit VW që ofrojnë shërbime (si p.sh. shërbime TI) për kompaninë Audi (VW AG),
- Ofruesit e shërbimeve të arkivimit,
- Ofruesit e shërbimeve të bartjes së faqes së internetit në rrjet,
- Ofruesit e shërbimeve TI dhe.

2. Palët e treta

Ne i transferojmë të dhënat tuaja personale tek marrësit ose kategoritë e marrësve si më poshtë, të cilët përfshihen në zhvillimin e produktit dhe vlerësimin të provave dhe që veprojnë si kontrollues sipas ligjit të zbatueshëm për mbrojtjen e të dhënave:

- Shoqëritë brenda grupit Audi,
- Shoqëritë brenda grupit VW,
- Partnerët e zhvillimit,

- Universitetet,
- Autoritetet sipas fushës së tyre të përgjegjësisë (p.sh. zyra e tatim-taksave, policia, prokuroria) dhe
- Gjykatat.

Me kënaqësi do t'ju ofrojmë informacione të mëtejshme rreth marrësve në lidhje me provat individuale të drejtimit të automjetit. Për çdo kërkesë, lutemi të na kontaktoni në adresat e mëposhtme

3. A transferohen të dhënat në një shtet të tretë?

Në disa raste, të dhënat personale mund të transferohen në një shtet jashtë Bashkimit Evropian ose Zonës Ekonomike Evropiane (i ashtuquajtur shtet i tretë). Nëse marrësi ndodhet në një shtet të tretë, të dhënat mund të transferohen në një shtet që mund të mos ketë një nivel të mjaftueshëm për mbrojtjen e të dhënave, d.m.th një nivel të krahasueshëm me atë të BE-së.

Në rast transferimi të të dhënave në shtete të treta që nuk kanë nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave, ne sigurohemi, para përhapjes, që marrësi ose ka një nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave (p.sh. ka një vendim të Komisionit të BE-së mbi mjaftueshmërinë ose një marrëveshje të ashtuquajtur Dispozitat Kontraktuese Standarde mes Bashkimit Evropian dhe marrësit), ose ne kemi marrë pëlqimin tuaj të shprehur.

Mund të merrni nga ne një kopje të rregullave specifike të zbatueshme ose të rëna dakord për të siguruar nivelin e mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave. Për këtë qëllim, ju lutemi t'i drejtoni kërkesat në adresat e kontaktit të dhëna në pikën B. të kësaj politike të privatësisë .

Hollësitë mbi transferimin e të dhënave tek shtete të treta, nëse është e mundur, do të paraqiten në këtë pikë ose mund të gjenden në këtë lidhje.

<https://gdpr.audi.com/>

VII. Për sa kohë do të ruhen të dhënat e mia?

Të dhënat e mbledhura gjatë përdorimit të automjetit të provës do të ruhen për aq kohë sa është e nevojshme për qëllimin e testimit dhe provave.

Pas përmbushjes së këtyre qëllimeve, të dhënat tuaja do të fshihen. Në disa raste, mund të jetë e nevojshme që të dhënat të ruhen përtej kësaj periudhe kohe për shkak të masave të sigurimit të cilësisë, përfshirë për qëllimet e zhvillimit dhe vëzhgimeve afatgjata (qëllimet e dokumentimit dhe mbajtjes së të dhënave të produktit). Gjithashtu, të dhënat do të ruhen nëse kompania Audi mbart detyrimin ligjor për arkivimin e tyre, nëse përpunimi i mëtejshëm i shërben konstatimit, ushtrimit apo mbrojtjes së pretendimeve ligjore, ose është i nevojshëm për realizimin e qëllimeve të kërkimit shkencor.
